



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2026

“PËR

**NGRITJEN E TASK-FORCËS NDËRINSTITUCIONALE  
TË SEZONIT TURISTIK 2026”**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të Ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të Ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe pikës 1, të nenit 5, të vendimit nr. 649, datë 16.10.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit””, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit Kulturës dhe Sportit,

**URDHËROJ:**

1. Ngritjen e Task-Forcës Ndërinstitucionale të sezonit turistik 2026, e cila asiston Komitetin për Menaxhimin e Sezonit Turistik (KMST) dhe është përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin në afat të masave përgatitore të përcaktuara në planin e masave për sezonin turistik.
2. Miratimin e planit të masave për sezonin turistik 2026, sipas shtojcës që i bashkëlidhet këtij urdhri.
3. Task-Forca e sezonit turistik 2026 kryesohet nga ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe ka në përbërje anëtarët, si më poshtë vijon:
  - a) Zëvendësministrin e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit;
  - b) Drejtorin e Përgjithshëm të Autoritetit Rrugor Shqiptar;
  - c) Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
  - ç) Drejtorin e Departamentit për Rendin dhe Sigurinë Publike, në Policinë e Shtetit;

- d) Drejtorin e Departamentit për Kufirin dhe Emigracionin, në Policinë e Shtetit;
- dh) Kryeinspektorin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor;
- e) Drejtorin e Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, në Drejtorinë e Përgjithshëm të Tatimeve;
- ë) Drejtorin e Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
- f) Kryeinspektorin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit;
- g) Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;
- gj) Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit;
- h) Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Turizmit;
- i) Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit;
- j) Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;
- k) Drejtorin e Përgjithshëm të Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit;
- l) Drejtorin e Përgjithshëm të Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- ll) Drejtorin e Përgjithshëm të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- m) Drejtorin e Drejtorisë së Huamarrjes Nëpërmjet Instrumenteve Financiare, në Ministrinë e Financave;
- n) Drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë së Politikave dhe Çështjeve Vendore;
- nj) Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;
- o) Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- p) Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit;
- q) Drejtorin e Përgjithshëm të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore;
- r) Drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme Detare.

4. Task-Forca e sezonit turistik 2026, për përmbushjen e misionit të saj, ka këto detyra:

- a) Të përditësojë dhe plotësojë të gjitha rubrikat përbërëse të planit të masave, të përmendura në pikën 2, të këtij urdhri;
- b) Të udhëzojë përgatitjen dhe të miratojë tërësinë e veprimtarive që do të kryejë çdo institucion/agjenci zbatuese, në zbatim të planit të masave për sezonin turistik;
- c) Të bashkërendojë veprimtaritë ndërmjet institucioneve zbatuese;
- ç) Të bashkëpunojë dhe bashkërendojë koordinimin e punës së strukturave qendrore, pjesë përbërëse e Task – Forcës me njësitë e vetëqeverisjes

- vendore, për zbatimin e planit kombëtar dhe vendor, të masave për sezonin turistik 2026;
- d) Të propozojë, nëse është e nevojshme, nxjerrjen e akteve nënligjore, që i shërbejnë zbatimit të masave përgatitore, sipas planit të masave;
  - dh) Të analizojë në vijimësi zbatimin e masave për çdo institucion;
  - e) Të përcaktojë përgjegjësitë e të propozojë masa administrative në çdo rast të moszbatimit të veprimtarive të planifikuara dhe të mosarritjes së rezultateve të pritshme;
  - ë) Të ngarkojë me detyra drejtuesit dhe strukturat zbatuese të drejtpërdrejta, të veprimtarive të planifikuara në planin e masave për sezonin turistik. Gjithashtu, ato kanë detyrë të raportojnë dhe informojnë Task – Forcën në lidhje me ecurinë e zbatimit të detyrave.
5. Task-Forca e sezonit turistik 2026 mblidhet çdo herë me njoftimin e kryetarit ose të personit të autorizuar prej tij.
  6. Në funksion të zbatimit të planit të masave, kryetari dhe secili prej anëtarëve të Task – Forcës të ndjekë ecurinë e veprimtarive të miratuara prej saj për institucionin/agjencinë zbatuese që ata përfaqësojnë.
  7. Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit, nëpërmjet personit të autorizuar ose pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në mbledhjet e Task – Forcës, informohet për zbatimin e planit të masave për sezonin turistik dhe i raporton Kryeministrit për rezultatet e arritura dhe për çështje të rëndësishme që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme.
  8. Ngarkohen titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 3, dhe në planin e masave, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij urdhri, të nxjerrin urdhrat përkatës dhe planin e detajuar të masave, në zbatim të tij.
  9. Ngarkohet kryetari i Task – Forcës ose personi i autorizuar prej tij për njoftimin e anëtarëve për mbledhjen e parë të saj menjëherë nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
  10. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe anëtarët e Task – Forcës për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**